



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E LICENCËS SË AVANCUAR PËR MËSUES TË ARSIMIT FILLOR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR  
MARRJEN E LICENCËS SË AVANCUAR PËR  
MËSUES TË ARSIMIT FILLOR**

# Shkurtesat

AF	Arsimi Fillor
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
FE	Fakulteti i Edukimit
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
ISCED	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
KB	Kurrikula Bërthamë
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KKK	Korniza Kurrikulare e Kosovës
KSZHM	Kornizë Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve
KSHLM	<i>Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve</i>
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PISA	Program për Vlerësim Ndërkombëtar të Studentëve
PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UA	Udhëzim Administrativ
VPM	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
ZHPBSH	Zhvillim Profesional me Bazë në Shkollë
ZHPM	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

*SHËNIM: Ky dokument bazohet në materialet e përgatitura nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) në Republikën e Shqipërisë. Përshatja e me kontekstin dhe specifikat e arsimit në Kosovë, është bërë me marrëveshje dhe në bashkëpunim me ekspertë nga ASCAP.*

# Tabela e përmbajtjes

<b>Shkurtesat.....</b>	<b>2</b>
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>4</b>
1.1. Synimet dhe qëllimet e programit- programi orientues i zhvillimit profesional për mësuesit e arsimit fillor - ciklit klasor.....	5
<b>2. Përmbajtja e programit për mësues të arsimit fillor .....</b>	<b>6</b>
2.1.Fusha: Dokumentacioni zyrtar shkollor .....	7
2.2.Fusha: Kurrikula – programet e të gjitha lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën.....	8
2.3. Fusha: Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë, vlerësimit dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënien e arsimit fillor .....	9
2.4.Fusha: Gjithëpërfshirja dhe etika në profesion.....	11
2.5.Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe .....	12
2.6.Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor.....	12
<b>3. Modele të testeve për mësues të arsimit fillor .....</b>	<b>12</b>

# 1. Hyrje

Profesioni i mësuesisë është profesion dinamik për të cilin nevojiten njohuri, aftësi dhe vlera të nevojshme për të kryer profesionin e mësuesit në arsimin fillor. Sot, fokusi detyrave dhe përgjegjësive për një mësues, shkon përtej mësimdhënies dhe zotërimit të një lënde mësimore të caktuar, në drejtim të zhvillimit të kompetencave të nxënësve përmes zbatimit të modeleve alternative të mësimdhënies dhe të nxënësve. Për të arritur këtë, mësuesit përgatiten në disa aspekte, si:

- të veprojnë me profesionalizëm, ndershmëri dhe integritet;
- të kenë njohuri të duhura dhe të nevojshme shkencore për fushën përkatëse të mësimdhënies;
- të zhvillojnë praktika cilësore të mësimdhënies;
- të përditësojnë njohuritë dhe shkathtësitë pedagogjike, metodike, didaktike, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe hulumtimit të praktikave të reja mësimore;
- të krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale, si dhe
- të bashkëpunojnë me prindërit dhe komunitetin e shkollës në interesin më të mirë të nxënësve, përkatësisht në funksion të të mësuarit të secilit nxënës.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e licencës së avancuar të mësuesve të arsimit fillor, është pjesë e paketës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve, e cila udhëheq zhvillimin e mësimdhënësve për praktikën më efektive të mësimdhënies, për të arritur standarde të larta në punë dhe në sjellje që lidhen me pritshmëritë për mësimdhënës të avancuar.

Programi është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të arsimit fillor në përgatitjen për provimin kualifikues dhe për vlerësimin e performancës për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- të gjithë mekanizmeve që merren me organizimin e provimit të kualifikimit për licencë të avancuar për mësimdhënie;
- Inspektoratit të Arsimit (IA) si bartës të procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës së mësimdhënësve (VPM) për licencë të avancuar për mësimdhënie; si dhe
- Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Shkollave për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësimdhënësit dhe për të zhvilluar përgatitjet me mësimdhënësit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave për kompetencat e mësimdhënësve që MASHTI, ka vendosur në dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KSZHM)<sup>1</sup>, në dokumentet e sistemit të licencimit të mësimdhënësve, kërkesat për mësimdhënësit që synojnë marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie.

---

<sup>1</sup> Duke marrë për bazë referimin hyrës të dokumentit në të cilin theksohet se Korniza do të jetë një dokument i gjallë i cili do të plotësohet dhe zhvillohet vazhdimisht krahas zhvillimeve të reja në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve dhe procesit të licencimit, grupi punues ka zhvilluar më tutje aspekte të rëndësishme të fushave të zhvillimit profesional dhe të kompetencave profesionale që lidhen me marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie. Ato reflektohen në këtë program orientues të zhvillimit profesional.

## 1.1. Synimet dhe qëllimet e programit- programi orientues i zhvillimit profesional për mësuesit e arsimit fillor - ciklit klasor

Synimi i përgjithshëm i këtij programi orientues të zhvillimit profesional për mësuesit e ciklit klasor është të sigurojë një kornizë dhe udhëzime për provimin e kualifikimit për efekt marrjen e licencës së avancuar. Qëllimet e veçanta janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit fillor për të realizuar veprimtaritë përgatitore profesionale, trajnuese për provimin për kualifikim dhe për vlerësim të performancës për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë DKA-ve, shkollave dhe të gjithë ofruesve të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve në shërbim, për të zhvilluar dhe ofruar programe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve (ZHPM), që ndihmojnë përgatitjen e tyre për marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit e arsimit fillor që synojnë marrjen e licencës së avancuar për mësimdhënie, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka procesi i provimit të kualifikimit dhe VPM për licencë të avancuar.

***Programi ka për qëllim që të orientojë zhvillimin e mësuesve të arsimit fillor në drejtim të marrjes së licencës së avancuar, për të cilën nevojitet:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit, përkatësisht çështjet kryesore që janë vendosur nga MASHTI, përgjegjësitë karshi dokumentacionit shkollor, detyrimeve dhe obligimeve të punës;
- të tregojë kompetencë në njohjen dhe zbatimin në mënyrë efektive të kurrikulës së bazuar në kompetenca - programeve lëndore të arsimit fillor;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale për mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, shtjellimin e koncepteve, nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me bazë kompetencat digjitale;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve, kërkesave të kurrikulës së bazuar në kompetenca.
- të demonstrojë etikë profesionale, qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve, të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës, si dhe të demonstrojë etikë profesionale;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënies – nxënies;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësitë shkencore të lëndëve që i mbulon në arsimin fillor si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve në arsimin fillor;

- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që ndërlidhen me çështjet ndërkurrikulare dhe kanë të bëjnë me edukimin për qytetari demokratike, çështjet e barazisë gjinore, edukimin për paqe, globalizimin dhe ndërvarësinë, edukimin për media, arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen.

## 2. Përmbajtja e programit për mësues të arsimit fillor

Përmbajtja e programit orientues për marrjen e licencës së avancuar për mësues të arsimit fillor është e organizuar në dy pjesë:

- Pjesa e parë**, përfshihen fushat kryesore të zhvillimit profesional, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme sipas kompetencave profesionale;
- Pjesa e dytë**, përfshin një model të testit të provimit të kualifikimit për marrjen e licencës së avancuar të mësuesve të arsimit fillor.

### *Fushat kryesore të zhvillimit profesional, kompetencat profesionale dhe rezultatet e pritshme*

Fushat kryesore të zhvillimit profesional ku verifikohen kompetencat e mësimeve për licencë të avancuar përdoren si ombrellë udhëzuese për të përcaktuar pritshmëritë mbi të cilat organizohen kërkesat/pyetjet për instrumentet e vlerësimit për provimin e kualifikimit dhe vlerësimin e performancës, për marrjen e licencës së avancuar për mësimeve. Fushat kryesore të zhvillimit profesional të përcaktuara për këtë program orientues janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>2</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë edukative-arsimore të mësimeve në shkollë;
- kurrikula – programet e **të gjitha lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën**;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë së mësimeve dhe vlerësimit, si dhe përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimeve dhe të nxënësve në arsimin fillor;
- gjithëpërfshirja dhe etika në profesion;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën.

FUSHAT	KOMPETENCAT
I. Dokumentacioni zyrtar shkollor	Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave ligjore të lidhura me dokumentacionin zyrtar shkollor.
II. Kurrikula – programet e të gjitha lëndëve të arsimit fillor, nga klasa e parë në të pestën	Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore në arsimin fillor.

2 I referohet kuadrit të politikave ligjore të arsimit parauniversitar në Kosovë, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve e politika arsimore që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

III. Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë, vlerësimit dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënien e arsimit fillor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor.</li> <li>2.Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe strategjive efektive të punës me nxënësit e fillor dhe realizimi i integritit ndër lëndor.</li> <li>3.Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive për vlerësimin e nxënësve në arsimin fillor.</li> <li>4.Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor.</li> </ol>
IV. Gjithëpërfshirja dhe etika në profesion	Zbatimi i parimeve të gjithëpërfshirjes dhe rregullave etikës në profesion si elemente të domosdoshme në punën e mësimdhëniesit të arsimit fillor.
V. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
VI. Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor	Zbatimi me kompetencë i përmbajtjeve shkencore në mësimdhënien e lëndëve të arsimit fillor.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave; dhe
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të provimit të kualifikimit dhe të VPM, do ta ndihmojnë mësimdhënësin që të identifikoj çështjet në të cilat duhet të përqendrohet gjatë përgatitjeve për këtë proces, dhe për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Rezultatet e pritshme dhe literatura e rekomanduar për çdo fushë të zhvillimit profesional pasqyrohen në pjesën në vijim.

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave ligjore të lidhura me dokumentacionin zyrtar shkollor”</p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton legjislacionin për sistemin arsimor parauniversitar, udhëzimet administrative dhe dokumentet tjera që lidhen me hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASHTIit në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011). <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770</a></li> <li>• Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (MASHTI &amp; IPK). <a href="https://ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/02/Korniza-per-sigurim-te-cilesise-se-performances-se-shkolles-ne-Kosove-2016.pdf">https://ipkmasht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/02/Korniza-per-sigurim-te-cilesise-se-performances-se-shkolles-ne-Kosove-2016.pdf</a></li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton kërkesat ligjore, administrative dhe organizative të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të profesionit;</li> <li>• respekton të drejtat, liritë e nxënësit dhe përgjegjësitë;</li> <li>• respekton, detyrat, të drejtat, liritë dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit;</li> <li>• zbaton kërkesat e udhëzimeve administrative dhe udhëzuesit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi administrativ nr. 22/2016 për Aktivitetet profesionale (Departamentet) të shkollave. Prishtinë: MASHT. <a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15199">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15199</a></li> <li>• Udhëzimi administrativ nr. 14/2023 Për sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie nr. 16/ 2023 për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. <a href="https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/">https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/</a></li> </ul>
---	--

<b>Kompetenca</b> “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore në arsimin fillor.”	Literatura e rekomanduar
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon njohje të reformës kurrikulare, aspekteve të reformës të lidhura me arsimin fillor;</li> <li>• zbaton kurrikulën e lëndëve të arsimit fillor duke respektuar të gjitha aspektet e organizimit të kurrikulës lëndore;</li> <li>• përdor me efikasitet parimet e kurrikulës në planifikimin dhe zbatimin e programeve të arsimit fillor;</li> <li>• përdor materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësi të parashikuara në kurrikulat lëndore të arsimit fillor;</li> <li>• harton rezultate të nxënësve për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me orientimet dhe kërkesat e kurrikulës bërthamë dhe programeve lëndore të arsimit fillor;</li> <li>• kategorizon rezultatet e të nxënësve të programit të lëndës/ve sipas niveleve të arritjes së të nxënësve;</li> <li>• shpjegon lidhjen program lëndor - tekst shkollor -planifikim mësimor vjetor dhe për gjysmëvjetor/periudha mësimore;</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve të nxënësve të programeve të arsimit fillor;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi korrelacionin e lëndëve dhe të çështjeve ndërkurrikulare me kontekstin e jetës së përditshme;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar, 2016); <a href="https://rks-gov.net/KornizaKurrikulareeArsimitParauniversitarteteRepublikesseeKosoves-MASHT">Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës - MASHT (rks-gov.net)</a></li> <li>• Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V) (e rishikuar, 2016). <a href="https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf">https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf</a></li> <li>• Kurrikulat lëndore të arsimit fillor, klasat I-V (2017 – 2021); <a href="https://masht.rks-gov.net/kurrikulat-lendore-programet-mesimore-klase-e-katert/">https://masht.rks-gov.net/kurrikulat-lendore-programet-mesimore-klase-e-katert/</a></li> <li>• Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës (material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor) (IPK &amp; MASHT, 2016).</li> <li>• <a href="#">Mësimdhënia efektive dhe kurrikula, prof. Naser Zabeli (2023);</a></li> <li>• Teori dhe strategji të mësimdhënies – Qasja konstruktiviste, prof. Xhavit Rexhaj (2019);</li> </ul>

<p><b>Kompetenca I</b>          “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>tregon njohje të mirë të aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, stileve të të nxënit dhe psikologjisë së moshës së nxënësve me të cilët punon;</li> <li>shfrytëzon literaturën bashkëkohore pedagogjike për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit;</li> <li>përshtat punën e tij/saj me zhvillimin fizik, social, emocional dhe kognitiv të nxënësve;</li> <li>krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>menaxhon situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish;</li> <li>zhvillon mësimdhënie të diferencuar;</li> <li>dallon vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar;</li> <li>punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar, 2016);</li> <li>Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V) (e rishikuar, 2016).</li> <li>Programi i KosEd: Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi. <a href="https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program">https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program</a></li> <li>Kurrikulat lëndore të arsimit fillor, klasat I-V (2017 – 2021);</li> <li>Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës (material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor) (IPK &amp; MASHT, 2016).</li> <li><u><a href="#">Mësimdhënia efektive dhe kurrikula, prof. Naser Zabeli (2023);</a></u></li> <li><u><a href="#">Teori dhe strategji të mësimdhënies – Qasja konstruktiviste, prof. Xhavit Rexhaj (2019);</a></u></li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b>          “Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe strategjive efektive të punës me nxënësit e fillor, realizimi i integritimit ndërlëndor”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>përzgjedh metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me specifikat e lëndës/temën e mësimin, të përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënit;</li> <li>planifikon dhe përdor metoda, veprimtari mësimore që nxisin të menduarit kritik e krijues të nxënësve;</li> <li>planifikon dhe zhvillon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me bazë kompetencat dhe me qasje të integritimit ndërlëndor;</li> <li>përdor metoda dhe teknika të ndryshme mësimore që përkrijnë me moshën e nxënësve dhe stilet e ndryshme të të nxënit;</li> <li>krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen.</li> </ul>	<p>Dokumentet kurrikulare - pjesa e metodologjisë së mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar, 2016);</li> <li>Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V) (e rishikuar, 2016).</li> <li>Kurrikulat lëndore të arsimit fillor, klasat I-V (2017 – 2021);</li> <li>Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës (material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor) (IPK &amp; MASHT, 2016).</li> <li>Programi i KosEd: Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi. <a href="https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program">https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program</a></li> </ul>

<p><b>Kompetenca III</b> “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive për vlerësimin e nxënësve në arsimin fillor”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• integron në planifikim mësimor dhe zbaton gjatë procesit të të nxënësve teknika të ndryshme të vlerësimit formativ;</li> <li>• përdor mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve;</li> <li>• vëzhgon dhe vlerëson me përshkrim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të ndryshme;</li> <li>• dokumenton detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin e tyre në masim;</li> <li>• harton teste sipas kriterëve të caktuara për të vlerësuar njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve në lëndë të ndryshme të ciklit fillor;</li> <li>• vlerëson nxënësit duke u bazuar në nivelet e arritjeve;</li> <li>• punon me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës (2020). <a href="https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/korniza-komplet-shqip-2.pdf">https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/06/korniza-komplet-shqip-2.pdf</a></li> <li>• Udhëzim administrativ për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës (MASHTI, 2022) <a href="https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-mashti-06-2022-per-vleresimin-e-nxenesve-ne-arsimin-paraunivesitar-te-republikes-se-kosoves/">https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-mashti-06-2022-per-vleresimin-e-nxenesve-ne-arsimin-paraunivesitar-te-republikes-se-kosoves/</a></li> <li>• Udhëzimi administrativ: Kodi i Etikës për Vlerësimin e Nxënësve (2011). <a href="https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf">https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/ua-kodi-i-etik.pdf</a></li> <li>• Vlerësimi formativ (MASHT &amp; BEP, 2013).</li> <li>• Vlerësimi përmbledhës dhe hartimi i testit - Doracak për mësimdhënësit (MASHT &amp; GIZ, 2015).</li> </ul>
<p><b>Kompetenca IV</b> “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezenton materiale didaktike duke përdorur programe të përshtatshme kompjuterike për nxënësit e arsimit fillor;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë prezantime mësimore duke përdorur programe të përshtatshme kompjuterike të përshtatshme për moshën e tyre;</li> <li>• përdor platforma të ndryshme online, të cilat e ndihmojnë për një proces mësimor efektiv;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte lëndore, ndërkurrikulare, të cilat ndërthuren me përdorime materiale nga burime të internetit - nga uebsite, të përshtatshme me moshën e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste shkollore, materiale mësimore në ndihmë të mësuesve të ciklit klasor, që kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> <li>• Udhëzues për mësimdhënës- Udhëtimi nëpër internet (MASHTI). <a href="https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes/">https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes/</a></li> <li>• Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitalë për Mësimdhënësit (DigCompEdu)</li> <li>• <a href="https://shkollat.org/">https://shkollat.org/</a></li> </ul>

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi i parimeve të gjithëpërfshirjes dhe rregullave etikës në profesion si elemente të domosdoshme në punën e mësimit të arsimit fillor”</p> <p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton parimet e gjithëpërfshirjes gjatë punës me nxënës dhe gjithë komunitetin e shkollës;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj veçantive të nxënësve, mësuesit se si mësojnë, si dhe i përkrah ata në arritjen e rezultateve mësimore;</li> <li>• përdor strategji të komunikimit që synojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënësve dhe i trajton të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe me respekt;</li> <li>• respekton etikën profesionale dhe sillet me përgjegjësi ndaj nxënësve, prindërve, kolegëve mësimdhënës dhe udhëheqjes së shkollës;</li> </ul>	<p>Literatura e rekomanduar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi administrativ për përdorimin e planit individual të arsimit (MASHT, 2016). <a href="https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016">https://MASHT.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016</a></li> <li>• Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e Planit Individual të Arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (MASHT, 2017). <a href="https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijet-nxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene">https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijet-nxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene</a></li> <li>• Praktika të mira të gjithëpërfshirjes (MASHTI, 2017) <a href="https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijet-nxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene">https://MASHT.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijet-nxenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene</a>,</li> <li>• Doracak për mësimitdhënës – Ndërkulturalizmi në arsim (MASHTI, 2023). <a href="https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-nderkulturalizmi-ne-arsim/">https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-nderkulturalizmi-ne-arsim/</a></li> <li>• Udhëzues për mësimitdhënës - Të kuptojmë Aftësinë e Kufizuar (MASHTI, 2022). <a href="https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes-te-kuptojme-aftesine-e-kufizuar/">https://masht.rks-gov.net/udhezues-per-mesimdhenes-te-kuptojme-aftesine-e-kufizuar/</a></li> <li>• Kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta (MASHTI, 2022). <a href="https://masht.rks-gov.net/kornize-per-perfshirjen-e-nxenesve-me-nevoja-te-veçanta-arsimore-ne-shkollat-e-mesme-te-larta/">https://masht.rks-gov.net/kornize-per-perfshirjen-e-nxenesve-me-nevoja-te-veçanta-arsimore-ne-shkollat-e-mesme-te-larta/</a></li> <li>• Doracak për mësimitdhënës me aktivitete mbi të drejtat e fëmijëve (MASHTI, 2021). <a href="https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-me-aktivitete-mbi-te-drejtat-e-femijeve-2/">https://masht.rks-gov.net/doracak-per-mesimdhenes-me-aktivitete-mbi-te-drejtat-e-femijeve-2/</a></li> </ul>

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p> <p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar;</li> <li>• zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive mësimore dhe veprimtarive tjera në shkollë/ institucion arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi me kompetencë i përmbajtjeve shkencore në mësimdhënien e lëndëve të arsimit fillor”</p> <p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>zotëron</i> konceptet e lëndëve të arsimit fillor, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik;</li> <li>• <i>transmeton</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxëniet e nxënësve në arsimin fillor;</li> <li>• <i>zotëron</i> njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitojnë nxënësit nga klasa 1-5 për çdo program lëndor;</li> <li>• <i>planifikon</i> sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor;</li> <li>• <i>përshtat</i> programet lëndore për nxënësit që paraqesin vështirësi në të nxënë ose që janë me aftësi të kufizuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V).</li> <li>• Të gjitha kurrikulat/programet lëndore që përmban plani mësimor, klasat 1-5.</li> <li>• Tekstet shkollore nga klasa 1-5.</li> <li>• Botime të ndryshme në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve të arsimit fillor.</li> </ul>

### 3. Modele të testeve për mësues të arsimit fillor

Modelet e testeve për provimin e kualifikimit për Mësues i arsimit fillor – ciklit klasor, janë zhvilluar dhe organizuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore dhe kompetencat në të cilat verifikohen njohuritë njohuri, aftësitë dhe vlerat e nevojshme për të ushtruar me sukses të lartë profesionin e mësuesit në arsimin fillor, me qëllim marrjen e licencës së avancuar të mësuesit të ciklit klasor.

Modelet e testeve për provimin e kualifikimit për marrjen e licencës së avancuar në mësimdhënie i gjejmë të organizuara në gjashtë fusha kryesore, ku pjesë e tyre janë kompetencat bazë të cilat së bashku me rezultatet e pritshme janë referenca në hartimin e kërkesave/pyetjeve të testeve.

Tabela në vijim prezenton përmbledhjen e fushave – rubrikave të testit të provimit të kualifikimit, për të cilat zhvillohen kërkesat/pyetjet sipas tri niveleve të arritjeve.

Nr.	Rubrikat e testit	Pikë në test	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli bazë V)1 = 1 pikë	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli mesatar V)2 = 2 pikë	Numri i pyetjeve me alternativa, niveli i lartë V)3 = 3 pikë
1.	Dokumentacioni zyrtar shkollor	4 pikë	0	2	0
2.	Kurrikula - Programi lëndor	6 pikë	0	3	1
3.	Aspekte të metodologjisë dhe pedagogjisë	13 pikë	4	3	1
4.	Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale	3 pikë	1	1	0
5.	Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	4 pikë	0	2	0
	<b>Totali i pyetjeve pjesa 1</b>	<b>30 pikë</b>	<b>5</b>	<b>11</b>	<b>2</b>
6.	Përmbajtja shkencore e lëndës	40 pikë	5	10	5
	<b>Totali i pyetjeve të testit</b>	<b>70 pikë</b>	<b>10 pyetje</b>	<b>21 pyetje</b>	<b>7 pyetje</b>

Modelet e testeve në vijim, përfshijnë disa kërkesa/pyetje (jo të gjitha në numër) për secilën fushë – rubrikë të provimit të kualifikimit për mësues të arsimit fillor. Ato përmbajnë pyetje me alternativa të shumëfishta, sipas niveleve të vështirësisë, me mundësi të përgjigjeve të sakta në një e më shumë alternativa.

### *I. Dokumentacioni zyrtar shkollor*

1. Përcaktoni standardet e mëposhtme që bëjnë pjesë në standardet e profesionit të mësimdhënësve sipas dokumentit Korniza Strategjike për Zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë: **1 pikë**
  - a. Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit;
  - b. Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
  - c. Menaxhon shkollën, aktivitetet dhe burimet e shkollës;
  - d. Siguron që të gjithë nxënësit e shkollës të mundësi të barabarta për nxënie cilësore.
  
2. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të: **1 pikë**
  - a. parimeve kryesore të kurrikulës dhe kompetencave kryesore të kurrikulës;
  - b. parimeve kryesore të kurrikulës dhe fushave të kurrikulës;
  - c. parimeve kryesore të kurrikulës dhe fushave të cilësisë së shkollës;
  - d. parimeve kryesore të kurrikulës dhe qëllimeve të arsimit parauniversitar.

### *II. Kurrikula - Programi lëndor i matematikës*

3. Cili nga konceptet në vijim shpreh kritere të unifikuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse: **1 pikë**
  - a. Shkallët e kurrikulës;
  - b. Llojet e vlerësimit;
  - c. Nivelet e arritjes;
  - d. Kompetencat kryesore.
  
4. Cilat nga rezultatet e të nxënit të lëndës së matematikës- klasa 2 lidhen me temën mësimore- Numrat natyrorë: **1 pikë**
  - a. Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme;
  - b. Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa);
  - c. Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jo standarde dhe standarde;
  - d. Përdorë vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.



5. Çështjeve ndërkurrikulare të përcaktuara në kurrikulën bërthamë dhe kurrikulat lëndore të arsimit fillor janë: **1 pikë**
- Tërësia e njohurive pak a shumë sistematike, të përvetësuara në një fushë të caktuar;
  - Pjesa zgjedhore e kurrikulës që përfaqëson lëndët dhe aktivitetet kurrikulare të vendosura në nivelin e shkollës;
  - Përmbajte e rëndësishme kurrikulare që nuk i përket krejtësisht vetëm një lënde apo fushe të kurrikulës, por që mësohet në disa lëndë;
  - Veprimtari të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore formale.

### *III. Aspekte të metodologjisë dhe pedagogjisë*

6. Cili nga aspektet në vijim i shërbejnë më së shumti përshtatjes së fëmijëve të arsimit fillor për të sistemuar të nxënit nëpërmjet lojës, punës, mësimit si dhe aftësimit të tyre për të bërë dallimin mes lojës dhe detyrës: **1 pikë**
- përvojat mësimore;
  - metodat e mësimdhënies;
  - punët praktike;
  - detyrat shkencore.
7. Nxënësit arrijnë të nxënë deri në 90% të rezultateve të të nxënit në klasë, nëse: **1 pikë**
- lexojnë tekstin;
  - dëgjojnë me vëmendje mësuesin;
  - shikojnë figura apo video;
  - krijojnë modele dhe prezantojnë punët e tyre.
8. Gjatë planifikimit të një testi përmblendhës për klasën e 5-të, hapi i parë që duhet të kryejë mësuesi, është: **1 pikë**
- përcaktimi i llojeve të pyetjeve dhe i pikëve që do të ketë testi;
  - përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit;
  - hartimi i skemës së vlerësimit të testit;
  - përcaktimi i rezultateve të të nxënit që do të vlerësohen në test.



#### *IV. Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etikës profesionale*

9. Mësuesja e klasës së 4-të, ka planifikuar një vizitë me nxënësit e saj në teatrin e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesja, në mënyrë që edhe Alba, një vajzë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë teatrin e qytetit së bashku me shokët dhe shoqet e klasës? **1 pikë**
- a. I kërkon mësueses së klasës tjetër për ta shoqëruar Albën në këtë vizitë;
  - b. Shkon më parë në teatrin e qytetit dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësja e saj dhe bën një planifikim paraprak;
  - c. E inkurajon dhe i kërkon Albës të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës në teatër;
  - d. I kërkon Albës të vijë e shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i/e cili/a do ta shoqërojë atë.
10. Një klasë gjithëpërfshirëse është ajo ku: **1 pikë**
- a. Vlerësimet përsëriten derisa çdo nxënës të arrijë rezultatet minimale;
  - b. Mësuesi/ja japin mësim duke iu referuar vetëm tekstit mësimor për të pakësuar ngarkesën e nxënësve;
  - c. Ka një përfshirje aktive të nxënësve me rezultate të larta;
  - d. Mësuesi/ja krijon për çdo nxënës praktika dhe përvoja të ndryshme të nxënësve.

#### *V. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe*

11. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**
- a. Klasat 3-ta të shkollës;
  - b. Klasat e 3 të shkollës;
  - c. Klasat e 3-ta të shkollës;
  - d. Klasat e 3-të të shkollës.
12. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**
- a. Komisioni për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka;
  - b. Komisioni për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka;
  - c. Komisioni për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin mjeko-ligjor kur fëmija nuk e ka;
  - d. Komisioni për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë rekomandon pajisjen e fëmijës me Raportin mjekoligjor kur fëmija nuk e ka.

## *VI. Përmbajtja shkencore e lëndëve të arsimit fillor*

### **Letër nga fshati**

Sokol!

Letrën ta vonova, se të prisnim, por ti s'pasje mundësi që të na vish. Tani do të të tregoj diçka për fshatin tim. Merr me mend një liqen të bukur, rrethuar me male të larta e të bleruara në dimër e verë. Merr me mend edhe një vargmal, siç është Mali i Thatë dhe në këmbë të tij një fushë që shtrihet tatëpjetë e vjen e puthet me ujërat e liqenit. Merr me mend se nga kjo fushë shkëputet një gadishull që futet edhe më thellë në liqen. Këtu është fshati ynë, Kallamasi ynë. Me të vërtetë natyrën e kemi shumë të bukur dhe të gjithë miqtë që na vijnë, mbeten gojëhapur. Ujërat e liqenit na rrethojnë nga të tria anët e ne jemi bërë shokë që në foshnjëri me këto ujëra. Kushedi sa herë i kam vajtur nënës në shtëpi si pulë e lagur. Ajo e shkreta më rrëmbente, më shtrëngonte në gjë e shpejt m'i ndërronte rrobat. Një marrëzi të tillë e bëra edhe vjet. E që thua ti, më thërret Pirroja i gëzuar që të shkonim të luanim te Lëndina e Kosornikut. E ne aty vajtëm. Na erdhi edhe Vasoja, edhe Gjergji, edhe Todri. Filluam lojën. Po do ti, i jap një shkelm të fortë e fërr..... topi mu në mes të liqenit. Po tani? Mua sa s'më ra pika! Nuk m'u durua: mbylla sytë e u futa në ujë. E di ti? Me gjithë rroba! Topin e shpëtova, por unë u bëra gazi i shokëve.

Ja kështu na gënjen liqeni, të tilla ngatërresa kemi me të. Jo vetëm verës, por edhe dimrit jemi miq me liqenin. Na pëlqen shumë edhe kur është i zemëruar me ato dallgët e shkumëzuara e të tërbuara. E di ti ç' bëmë ne? Vemi në zallishte dhe përpiqemi të gënjejmë dallgët. Kur tërhiqet dallga nga bregu, ne e ndjekim valën në thellësi. Kur fryhet ajo si e zemëruar, ne rendim të largohemi. Por shpesh herë ajo na mund: se si na gënjen e sakaq me plluppllup na mbushen këpucët me ujë. Ne shkulemi së qeshuri! Duke dashur që t'i largohemi sa më shpejt dallgës, pengohemi dhe bëlldum biem në ujë. Dallga na kalon mbi trup dhe na bën qull.

Por fshati ynë ka dhe bukuri të tjera; për këto do të të shkruaj herë pas here. Mos harro dhe ti: dua të më shkruash me gjatë për fshatin tënd.

Mirupafshim! Ylli

13. Teksti i dhënë është:

1 pikë

- a. Letër personale;
- b. Letër zyrtare;
- c. Ftesë;
- d. Ditar.

14. Në fjalinë: “Merr me mend një liqen të bukur, rrethuar me male të larta”, fjala të bukur është:  
1 pikë

- a. Mbiemër;
- b. Parafjalë;
- c. Ndajfolje;
- d. Emër.

**“Dashuria për vendin tënd”**

Po udhëtojmë drejt Adriatikut. Kemi bërë një udhë shumë të gjatë, duke ndërruar shumë avionë nëpër aeroporte të ndryshme e të çuditshme. Gjumin e kemi bërë copa-copa, duke fluturuar mbi qytete të panjohura. Para se të mbërrijmë në Shqipëri ndalemi për pak ditë në Romë. Shëtisim nëpër rrugët e Romës. Është ftohtë. Nëntor. Udhëtimi nëpër kryeqytet sa vjen e bëhet më interesant. Befas syri ndalon tek një tabelë: Rruga “Gjergj Kastrioti”.

Një rrugë me mbishkrimin: “Këtu ka bujtur disa ditë Gjergj Kastrioti”. Ne nuk flasim fare. Mendohemi. Këtu ai erdhi pesë shekuj më parë. Zbriti nga kali dhe hyri te kjo ndërtesë. Banorët rreth e rrotull dolën në dritare për të parë mysafirin e huaj dhe të largët. Ai vinte nga një vend ku bëhej luftë e tmerrshme. Në dhomat e tij kish dritë gjer vonë. Mendohemi rreth asaj kohe, ndërsa shiu bie pa pushim. Hipim në makinë e largohemi në rrugët e pafund të qytetit. Nesër do të nisemi në Shqipëri. Avioni do ta lërë pas detin Adriatik. Poshtë reve, poshtë mjegullës, midis luginës së bukur, si një e njohur e vjetër, do të na shfaqet pista e aeroportit të Rinasit.

Mirë se të gjejmë, Atdhe!

*Ismail Kadare*

15. Nëpërmjet këtij fragmenti tregimtari ka për qëllim të rrëfejë: **1 pikë**

- a. Udhëtimin e tij të radhës;
- b. Peripecitë e papritura gjatë udhëtimit;
- c. Vendet që i kanë bërë më shumë përshtypje;
- d. Vendet që mbajnë emrin e heroit Gjergj Kastriot Skënderbeut.

16. Ky fragment ka elemente: **1 pikë**

- a. Shkencore;
- b. Biografike;
- c. Informuese;
- d. Autobiografike.

17. Nxënësit ulen në një klasë nëpër rreshta. Çdo rresht ka numër të njëjtë nxënësish. Janë 2 rreshta me nxënës para Rronit dhe një rresht nxënësish pas tij. Në rreshtin e Rronit, janë 3 nxënës në anën e majtë të tij dhe 5 nxënës në anën e djathtë të tij. Sa nxënës janë gjithsej në klasë?

**1 pikë**

- a. 10
- b. 17
- c. 18
- d. 27

*Është dhënë situata problemore: Agimi udhëtoi me makinë për 2 orët e para me shpejtësi 70km/orë dhe tre orët e tjera me shpejtësi 80 km/orë. Qarkoni alternativën e saktë për pyetjet 22 dhe 23.*

18. Agimi udhëtoi gjithsej:

**1 pikë**

- a. 150 km;
- b. 250 km;
- c. 340 km;
- d. 380 km.

19. Shpejtësia mesatare me të cilën udhëtoi Agimi është:

**1 pikë**

- a. 75 km/orë;
- b. 76 km/orë;
- c. 77 km/orë;
- d. 78 km/orë.



Kosovo Legal  
Services Company

IBE



EDUCATIONAL  
RESEARCH  
INSTITUTE



Ky dokument u prodhua me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe partnerëve të konsorciumit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.